

KONVENTA PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Grupi i Punës III (Bujqësia)

Sesioni 4, Tema: “Informaliteti në Sektorin e Bujqësisë dhe Kapaciteti për përthithjen e Fondeve Strukturore për Zhvillimin Rural”

Problematika dhe Rekomandime:

- **Nuk ka një ligj për subvencionin** që do të ndihmonte edhe në politika afatgjata. Nuk ofrohen kushtet dhe mbështetje në lidhje me projektet financuese që mund t'i ofrohen fermerëve shqiptarë.
- Deri tani janë financuar vetëm individë, pra financimi është bërë në mënyrë të fragmentarizuar. Duhet që në fokus të jetë e gjithë bujqësia dhe jo vetëm disa hallka të tij. Duhet të ndryshojë **koncepti i financimit dhe normat e interesit** duhet t'i përshtaten gjendjes së fermerëve, për t'i ndihmuar për investime, dhe jo thjesht për mbijetesë.
- Duhet sa më shpejt të **realizohet një Platformë Elektronike në bujqësi**. Fermerët duhet të pajisen me **kartë elektronike** për të formalizuar biznesin e tyre dhe për të lehtësuar procedurat e financimit dhe për më shumë fonde nga Bashkimi Europian.
- Projektet duhet të **jenë gjithëpërfshirëse**, dhe agrobizneset duhet të jenë pjesë e konsultimeve dhe të marrin pjesë në këto politika. Deri tani ato lihen mënjanë.
- **Krijimi i Shoqatave të Bashkëpunimit Bujqësor**, që ndihmojnë fermerët të aplikojnë së bashku për të përfituar fonde apo ndihma të tjera me kosto më të ulët. Duhet më shumë mbështetje nga shteti për këto shoqata për më shumë hapësira por edhe suport ekonomik.
- Duhet hequr dorë nga nafta e eksportit dhe të fillojë të përdoret ajo vendase, pasi dhe kostoja është më e ulët dhe gjithashtu ndihmon në zhvillimin e përgjithshëm të vendit. **Kosto më e ulët për fermerin** do të thotë më shumë kapital për investime. Në të kundërt të bëhet përpjekje për uljen e çmimit të karburantit për fermerin.
- **Ngritja e qendrave të formimit profesional** apo realizimi i seminareve për të përmirësuar dijet dhe njohuritë e fermerëve. Do të rriste efikasitetin e tyre dhe do t'i bënte më shumë konkurrues. Gjithashtu është një mundësi e mirë për të përfshirë edhe brezin e ri.

- Përmirësim i **Zyrave këshillimore**, sot një këshillues ka në ngarkim 2 mijë e 500 fermerë. Numër shumë i lartë dhe që e bën të pamundur këshillim efektiv dhe cilësor.
- Më shumë **bashkëpunim dhe mbështetje** mes aktorëve shtetërorë dhe organizatave jo qeveritare që kanë fokus bujqësinë dhe zhvillimin rural. Duhet mbështetje **për projektet** që këto organizata realizojnë si në logjistikë, teknologji struktura etj.
- Fermerit nuk duhet t'i ofrohet vetëm kredia si mbështetje, **por edhe mekanizmi i Sigurimit** të prodhimit bujqësor, ndërtesave, tokës makinerive etj. por sigurisht pa pasur si qellim shtimin e kostove, por për të lehtësuar barrën në raste dëmi apo vjedhjeje.
- Duhet realizuar një **Strategji afatgjate dhe një plan operacional për zhvillimin rural** dhe jo vetëm atë bujqësor. Fokusi nuk duhet të jetë vetëm të bujqësia, por te zhvillimi i gjithë zonës rurale.
- Statistikat janë me mjaft rëndësi, duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara dhe jo të hamendësuara. **Mungesa e informacionit të saktë statistikor** ndikon negativisht në hartimin e politikave dhe strategjive të duhura.
- **Legjislacioni** duhet shtuar dhe duhet përmirësuar, në raste të tjera është i nevojshëm zbatimi i tij me rigorozitet.
- Duhet hartuar një projekt për **Licencimin si proces**, me sanksione dhe penalizime të mirëpërcaktuara dhe të zbatueshme. Sot mos licencimi i një pjese të fermerëve ndikon te rritja e konkurrencës së pandershme dhe e kostos për bizneset që respektojnë rregullat.
- **Mungon ligji për standardin e prodhimit** që duhet të dalë në treg. Duhet që tregu të orientohet. Për sa i përket shëndetit të kafshës duhet realizuar **sistemi i gjurmueshmërisë dhe ai i matrikulimit**.
- Për sa i përket autoriteteve mbikëqyrëse dhe menaxhuese duhet të arrihen standardet e larta dhe sidomos **paanshmëria dhe pavarësia** në realizimin e funksioneve të tyre.
- **Subvencionimi i inputeve**, është procesi më i rëndësishëm i financimit dhe investimit ë bujqësi.

Pjesëmarrësit në Sesionin 4, të Grupit të Punës III :Institucione shtetërore dhe Shoqëri civile

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH)

z. Agim Rrapaj, Kryetar

znj. Enida Shema

z. Ymer Tola

z. Agim Soma

z. Ristan Janku

Uninoni Shqiptar Kursim Kredi: z. Kliton Vaso, z. Ndrëçim Xhyrja

Alfa Consulting: znj. Irena Shabanllari

EKR: z. Erdit Rrapaj

Fermerë dhe prodhues të Agrobiznesit:

z. Eran Platkin

z. Eduard Mara

z. Fatmir Gullbaqi

z. Vangjel Shtëmbari

z. Tomorr Kërçuku

z. Fatos Dako

z. Abdyl Korreshi

z. Blerim Korreshi

Ekspertë të grupit të punës: z. Florian Xhafa, EMA

Media: A1 Report dhe Shqiptarja.com, z. Ermir Dervishi